

VENDIM
Nr. 56, datë 26.3.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s, NR. 228, DATË 26.10.2018, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “OSOJA HPP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “OSOJE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1952 kw, NË ZONËN E MOGLICËS –KORÇË (LUMI OSOJË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 228, datë 26.10.2018, për licencimin e shoqërisë ‘Osoja HPP’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Osoje’, me kapacitet të instaluar 1952 kW, në zonën e Moglicës–Korçë (Lumi Osojë)”,

konstatoi se:

Me vendimin nr. 228, datë 26.10.2018, Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja” me fuqi 1952 kw, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë (Lumi Osojë) për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçarë).

2. Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k., duhet të përcjellë në ERE, ndryshimin e kontratës me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osojë”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 529, datë 26.2.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.

- Shoqëria, me shkresën nr. 10 prot., datë 4.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 529/1 prot., datë 6.3.2020, ka depozituar në ERE dokumentacionin si vijon:

- Kopje kontrate me nr. 2255 rep., nr. 1106/2 kol., datë 26.10.2018, të lidhur me palët: MIE dhe shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k.: Për amendim kontratën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit Osojë, me kapacitet prodhues 1.952 kW, në lumin e Osojës, degë e lumit Devoll, në Bashkinë Korçë, qarku Korçë, me nr. 1755 rep., nr. 776/3 kol., datë 25.7.2017, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive: “Favina” sh.p.k; “Favina 1” sh.p.k. dhe “ Osoja Energy” sh.p.k., me përfaqësues shoqërinë “Favina”, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osoje” me kapacitet prodhues 1952 kw, në lumin e Osojës, degë e lumit Devoll, në Bashkinë Korçë, qarku Korçë.

- Në nenin 2 të kontratës sipërcituar është parashikuar se: Kudo në kontratë togfjalëshi: “Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ‘Favina’ sh.p.k., ‘Osoja Energy’ sh.p.k. dhe ‘Fava 1’ sh.p.k.”, zëvendësohet me togfjalëshin: Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k.

- Shoqëria “Osoja HPP” sh.p.k. rezulton të ketë plotësuar detyrimin e parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 228, datë 26.10.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 26.10.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Osoja HPP’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Osoja’ me fuqi 1952 kW, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë, (lumi Osojë)”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) pika 2 shfuqizohet

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti